

K O N T R A T E

PER KRIJIMIN E SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
ALBANIAN FRANCE COMPANY (AFC shpk)

1 Hyrje

1.1 Palet

Ne kuptimi e kesaj kontrate, per krijimin e shoqerise tregetare me pergjegjesi te kufizuar qe ketu e me pas referohet si kontrate, palet jane :

1. Shpend Petrit Sjdarasi, lindur ne Durres me 13.2.1953, me banim ne qytetin e Tiranes, rruga Nasi Pavllo, pl5/1, ap 12.
2. Michel Lexcelent, lindur e banues ne Paris, i datlindjes 8.5.1934 ne adresen : 51, rruga Michelet 95320 ST.LIEU LA FORET.

1.2 Qellimi

Qellimi i kesaj kontrate eshte krijimi i shoqerise ndermjet paleve (qe ketu dhe me pas do te referohet si shoqeri). Kjo shoqeri do te quhet shoqeri tregetare me pergjegjesi te kufizuar Albanian France Company e emertuar shkurt A shpk, e cila do te zhvilloj aktivitetin e saj ne Republiken e Shqiperise.

2. Objekti

Shoqeria AFC shpk ka per objekt ushtrimin e veprimtaris tregetare, shit-blerjen e te gjitha produkteve me shumice e pakice, transaksioneve imobiliare (terene e ndertesa) e atyte tregetare, import, eksport, turizem, ndertim, aktivitete sherbimi ne fusha te ndryshme si hoteleri, restorante, transport, etj. Aktivitete prodhimi, bashkeprodhimi me ndermarje dhe shoqeri te vendit e te huaja transformim te gjithe produkteve, lojra fati e veprime komisionere.

3. Data efektive

Kjo kontrate do te jete efektive qe nga data kur eshte firmosur nga palet dhe mbi bazen e saj, te statutit te shoqerise dhe te kerkeses te jete e plotesuar e gjithe procedura ligjore dhe te jet bere rregjistrimi i saj si person juridik ne gjykatën e rrethit te Tiranes per fitimin e zotesise juridike per te punuar.

4. Afati

Kjo kontrate ndermjet paleve lidhet per nje afat te pa kufizuar, mbi dhjete vjete.

5. Interpretim dhe percaktim

5.1 Interpretimi

Fjalet dhe shprehjet e percaktuara ne qdo paragraf, per qellimet e neni per te cilin paragrafi bene pjese, do te mbajne dhe ruajne kuptimet e caktuara te fjaleve dhe shprehjeve ne keto paragrafe.

Kjo kontrate rregullohet dhe interpretohet ne pajtim me legjislacionin neshfuqi ne Republiken e Shqiperise.

Qdo reference ne Njejes perfshin dhe shumetin dhe anasjelltas.
Qdo reference ne gjini perfshin dhe gjinin tjeter.

5.2 Percaktim

Ne kete kontrate, fjalet dhe shprehjet vijuese, deri sa nuk pajtohen me kontekstin, do te kene kuptimet vijuese te percaktuara :

5.2.1 Palet

Palet do te nenkuptojne personat qe lidhin kete kontrate te percaktuar ne piken 1.1

5.2.2 Material konfidencial

Termi "material konfidencial" nenkupton te gjitha informacionin qe ka qene ose qe mund te shkembehet ndermjet paleve, perfshire por jo i kufizuar ne te shkruar, shtypshkruar, stampuar qe ekziston tani ose qe munde te zhvillohet me vone gjate veprimtarise se shoqerise, pavarsishte nga forma e komunikimit. Ne kete term perfshihet dhe te gjitha projektet e objekteve qe do te ndertohen ose shfrytezohen nga shoqeria.

"Termi Material konfidencial" nuk perfshine informacioni n qe eshte ne zotrim publik, ne se ka te till, ose qe munde te shkoje ne nje zotrim te till.

5.3 Data

Data do te nenkuptoj daten efektive te percaktuar ne nenin 3 te kesaj kontrate.

6. Konfidencialiteti

Palet e kesaj kontrate jane te detyruar si dhe personat qe do te punesohen ne kete shoqeri te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, informacionit, njohurive dhe pervojes se shkember si dhe te cdo materiali konfidencial. Per shkelje te tilla te perseritura, cilado pale e kesaj kontrate ka te drejte te kerkoje zgjidhjen e kontrates.

7. Shoqeria Tregetare (shpk)

Sipase kesaj kontrate palet bien dakorte per te krijuar nje shoqeri tregetare (shpk) per realizimin e veprimtarive te parashikuara ne objektin e kesaje kontrate. Shoqeria do te realizoj veprimtarine e saj me kontributin e te dy paleve.

7.2 Kapitali themelues

Kapitali themelues i shoqerise do te jete 3000 usd, 50% per cdo pale.

8 Detyrimet e paleve

Palet e kesaj kontrate jane te detyruara te zbatojne detyrimet e kesaj kontrate dhe statutit te shoqerise te miratuar prej tyre.

Palet e kesaj kontrate jane te detyruar te zbatojne te gjitha vendimet qe merren sipase menyres se percaktuar ne statut.

9. Pasuria e shoqerise

9.1 Ne emer te shoqerise do te kalojne te gjitha kontributet dhe kapitalet financiar te sjciles pale.

9.2 Ne emer te shoqerise do te kalojne te gjitha objektet qe munde te ndertohen,

mekinerit dhe mjetet kryesore.

10. Ndarja e fitimeve

Palet e kesaj kontrate bijen dakort qe ndarja e fitimeve te realizuara nga shoqeria te behet ne menyre te barabart ndermjet ortakve. Ky raport respektohet ne qdo rast me perjashtim te rasteve kur ortakët vendosin ndryshe.

11. Mbarimi i shoqërise

11.1 Veprimtaria e shoqërise mbaron me vendim te organit drejtues, ne raste se veprimtaria e saj nuk rezulton fitimprurëse.

11.2 Shoqeria mund te mbaroje dhe me ane te rëorganizimit te saj nepermjet formave te shkrirjes, thithjes dhe ndarjes,

11.3 Ne raste se shoqeria do te mbaroje, pasuria e saj do tu ndahet paleve ne baze te kontributit te sejciles pale, pasi te jene zbritur detyrimet per te trete. Vlersimi i pasurise se shoqërise behet me pjesmarjen e te dy paleve.

12. Juridiksioni

12.1 Shoqeria duke qene person juridik shqiptar e rregullon veprimtarine e saj ne baze te dispozitave te kesaj kontrate, te statutit dhe legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

12.2 Mosmarveshjet ndermjet paleve qe nuk munde te zgjidhen me pajtim, zgjidhen ne gjykatën e rrethit te Tiranes.

12.3 Shoqeria e ka seline e saj ne qytetin e Tiranes ku do te zhvillohet akti viteti i i saj kryesor. Ne te ardhmen ajo mund te krijoj dege te saj dhe ne rrethe te tjera.

12.4 Palet e kesaj kontrate pasi studiuën tekstin e kesaj kontrate, me vullnetin e ture te mire e nenshkruajne ate, duke marre persiper te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin prej saj.

O R T A K E T

Shpend Petrit/ Sejdarasi

Michel Lexcellent

Tirane me _____ 94.